



Pranuar / Dorezuar Puniljena/Prodato Received/Delivered	08.09.2023	3	viti god year
Organ /Bjesta Organ /Jednica Org. Abot	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHDK	6019/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1017/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1017/2023 të datës 21.07.2023 të parashtruar nga ankuesit

kundër organit të punësimit/ Agjencia për Menaxhimin Emerxhent, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 08.09.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Menaxhimin Emerxhent, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës me Nr. Port: 42 të datës 25.04.2023 të parashtruar nga ankuesit.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Me Vendimin me Nr.14/99 të datës 30.09.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është themeluar Komisioni Qendror për Vlerësimin e Dëmeve të Shkaktuara në të mirat materiale nga ndikimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera në të cilin komision janë përfshirë ankuesit.

Kryesuesi i këtij komisioni më datë 25.04.2023 në emër të komisionit ka parashtruar kërkesë me Nr. Port: 42, tek Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Menaxhimin Emerxhent për kompensim material në bazë të nenit 7 të Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë dhe nenit 9 të Rregullores (QRK) për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe të Tjera, mirëpo nuk kanë marr përgjigje,përkundër që kërkesa është nënshkruar edhe nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Menaxhimin Emerxhent .

Ankuesit si në preambulë të këtij vendimi, më datë 21.07.2023 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 5320/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 31.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Agjencia për Menaxhimin Emerxhent. Ndërsa Këshilli me datë 08.08.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendim me numër protokolli 5897/2023 të datës 30.08.2023 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës edhe për 10 ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ,me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5320/2023 të datës 21.07.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 25.04.2023 e parashtruar tek zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Menaxhimin Emerxhent; Vendimin me Nr. 14/99 të datës 30.09.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Qarkore rreth zbatimit të Rregullores Nr. 10/2022 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë e datës 22.03.2023; Emailin e datës 27.03.2023 nga Sh. A. për A.K; Emailin e datës 27.03.2023 nga A.L për K.L; Emailin e datës 20.04.2023 nga A.K për K.L; Emailin e datës 29.03.2023 nga K.L për F.T; Emailin e datë 20.06.2023 nga K.L për Sh.A dhe A.K; Emailin e datës 21.06.2023 nga K.L për I.B; Emailin e datës 21.06.2023 nga I.B për K.L; Vendimin e datës 07.06.2023 të pa nënshkruar përgatitur nga zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Menaxhimin Emerxhent; Emailin e datës 22.06.2023 nga K.L për ankuesit tjerë; Emailin e darës 22.06.2023 nga I.B për N.Sh dhe M.Q; Emailin e darës 16.05.2023 nga D.M për I.B; Emailin e datës 03.05.2023 nga I.B për M.B; Emailin e datës 11.05.2023 nga I.B për Sh.A; Emailin e datës 04.07.2023 nga I.B për Sh.A; Emailin e datës 03.07.2023 nga M.Q për I.B; Raporti për procedimin e lëndës për pagesë i datës 06.01.2023, 20.04.2023; Emaili i datës 24.04.2023 nga K.L për D.L; Lista e pjesëmarrësve në Komisionin për Vlerësimin e Dëmeve nga FNFT datës 19.07.2023, 18.07.2023, 17.07.2023, 03.07.2023, 04.07.2023, 05.07.2023, 06.07.2023, 07.07.2023, 20.06.2023, 19.06.2023, 14.06.2023, 07.06.2023, 06.06.2023, 01.06.2023, 20.04.2023, 19.04.2023, 31.03.2023, 29.03.2023, 28.03.2023, 20.03.2023, 17.03.2023, 16.03.2023, 15.03.2023, 07.03.2023, 06.03.2023, 03.03.2023, 02.03.2023, 31.03.2023, 07.02.2023, 23.02.2023, 20.07.2023; Procesverbalin e Komisionin për Vlerësimin e Raporteve të dërguara nga Komunitat për Dëmet e shkaktuara nga Fatkeqësitë

natyrore-vërshimet i datës 19.06.2023, 18.07.2023, 17.07.2023, 04.07.2023, 19.06.2023, 14.06.2023, 06.07.2023, 19.04.2023, 29.03.2023, 28.03.2023, 20.04.2023, 19.04.2023; Procesverbal i takimit të Komisionit për vlerësimin e dëmeve dhe FNFT i datës 15.03.2023, 08.03.2023; Procesverbal i datës 23.02.2023, 07.02.2023, 23.02.2023, 07.02.2023; Vendimin me Nr. 08/2023 i datës 06.01.2023; Vendimin me Nr. 08/2-023 i datës 01.03.2023; Emailin e datës 06.06.2023 nga K.L për D.L; Emailin e datës 24.04.2023 nga K.L për B.M; Vendimin me Nr. 05/2023 i datës 01.03.2023; Emailin e datës 01.03.2023 nga K.L për Z.E, B.H I.F, R.Sh, B.R; Vendimin me Nr. 04/2023 i datës 01.03.2023; Emailin e datës 30.05.2023 nga K.L për B.M; Vendimin me Nr. 06/2023 i datës 01.03.2023; Vendimin me Nr. 01/2023 i datës 01.03.2023; Vendimin me Nr. 01.2023 i datës 14.06.2023; Vendimin me Nr. 02/2023 i datës 14.06.2023; Vendimin me Nr. 04/2023 i datës 06.06.2023; Vendimin me Nr. 03/2023 i datës 14.06.2023; Vendimin me Nr. 03/2023 i datës 20.04.2023; Vendimin me Nr. 01/2023 i datës 20.04.2023; Vendimin me Nr. 02/2023 i datës 20.04.2023; Vendimin me Nr. 04/2023 i datës 20.04.2023; Vendimin me Nr. 08/2023 i datës 20.04.2023; Vendimin me Nr. 06/2023 i datës 20.04.2023; Vendimin me Nr. 05/2023 i datës 20.04.2023; Vendimin me Nr. 07/2023 i datës 20.04.2023; Vendimin me Nr. 06/2023 i datës 06.01.2023; Vendimin me Nr. 02/2023 i datës 06.01.2023; Vendimin me Nr. 05/2023 i datës 06.01.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 31.07.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 08.08.2023; Akt Emërimit NJBNJ-Nr.210/2023 i datës 08.06.2023 për ankuesin K.L; Emailin e datës 18.05.2023 nga M.Q për I.B; Emailin e datës 21.06.2023 nga I.B për M.Q; Emailin e datës 03.05.2023 nga I.B për M.B; Emailin e datës 22.05.2023 nga I.B për M.Q dhe S.B; Emailin e datës 21.06.2023 nga I.B për K.L; Raport për vizitë në terren i datës 08.03.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi, atëherë ekziston baza ligjore që të detyrohet zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Menaxhimin Emerxhent, që të bëjë shqyrtimin e kërkesës me Nr. Port: 42 të datës 25.04.2023 të parashtruar nga ankuesit dhe të nxjerr akt administrativ, *sepse:*

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë që në bazë të dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë dhe Rregullores (QRK) për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe të Tjera, ju takon kompensimi për funksion shtesë dhe për këtë ekziston vendimi por i njëjti nuk është nënshkruar nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Menaxhimin Emerxhent; po ashtu pretendojnë që kanë marr miratimin se ka bazë ligjore për këtë kompensim.

Kolegji i Këshillit lidhur me këtë çështje, në shqyrtim të pretendimeve ankimore ju referuar Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, respektivisht nenit 8 paragrafi 1 dhe 2, i cili përcakton se: *"1. Funkionarja/i publike, zyrtarja/i publike, zyrtaret/ët e/i tjera/ë, si dhe stafi akademik universitar që marrin pagën bazë sipas shtojcave të këtij ligji, nëse angazhohen me punë në një institucion tjetër publik, kur këtë e lejon ligji i veçantë, marrin pagesë, si pagë deri në njëzet për qind (20%) të pagës bazë për angazhimin në atë institucion. 2. Qeveria e Republikës së Kosovës me propozim të ministrisë përgjegjëse për financa dhe pëlqim të ministrisë përgjegjëse për administratën publike miraton me akt nënligjor, kushtet, masën dhe procedurën e pagesës për angazhimin shtesë sipas paragrafit 1. të këtij neni"*, nenit 38



të këtij ligji, i cili përcakton se: "Kur zyrtaret/ët publik, sipas legjislacionit në fuqi emërohen/caktohen që të shërbejnë në një bord, komision profesional apo organ tjetër publik që kërkon ekspertizë profesionale dhe përbën funksion shtesë për zyrtaren/in, ky/kjo zyrtar/e publik/e ka të drejtën e kompensimit shtesë për këtë funksion. 2. Kompensimi sipas pikës 1. të këtij neni nuk nënkupton detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pozita të cilën e mban zyrtarja/i publike, përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në komisione dhe/apo organe të tjera të themeluara brenda institucionit. 3. Kompensimi sipas këtij neni bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetaren/in dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët/ët, të pagës bazë së zyrtares/it kryesor administrativ të institucionit në të cilën themelohet bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik. 4. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mbledhet së paku një (1) herë në muaj, përfitohet çdo muaj, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 5. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mbledhet më rrallë se një (1) herë në muaj, kompensimi përfitohet për çdo mbledhje, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 6. Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike dhe pas pëlqimit nga ministria përgjegjëse për financa, me akt nënligjor miraton kriteret për përfitim të këtij kompensimi", si dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë.

Kolegji i Këshillit, marr për bazë provat e lëndës, si dhe Vendimin me Nr.14/99 të datës 30.09.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit është themeluar Komisioni Qendror për Vlerësimin e Dëmeve të Shkaktuara në të mirat materiale nga ndikimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, konstaton se më datë 07.06.2023 është nxjerr vendimi nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Menaxhimin Emerxhent përmes të cilit i lejohet kompensimin këtij komisioni, mirëpo ky vendim nuk është nënshkruar dhe si rezultat i kësaj nuk ka mund të prodhojë pasoja juridike.

Nga shqyrtimit i të gjitha provave të lëndës, si dhe duke marr për bazë se palët ankuese kanë dërguar tek institucioni prova materiale si procesverbale të takimeve të komisionit, vendime lidhur me natyrën e themelimit të këtij komisioni si dhe prova të tjera që dëshmojnë se të njëjtit kanë kryer punë të përcaktuara me Vendimin me Nr.14/99 të datës 30.09.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe me dispozitat ligjore në fuqi që burojnë lidhur me përgjegjësitë e këtij komisioni, atëherë Kolegji i Këshillit, thekson faktin se ankuesit kanë dërguar edhe materiale të tjera respektivisht komunikime zyrtare përmes emailit çoftë me zyrtarë të Agjencisë për Menaxhimin Emerxhent, Ministrisë së Punëve të Brendshme apo edhe Zyrës së Kryeministrit, e mbi bazë të tyre, nuk ka ndonjë përgjigje me të cilën decidivisht konstatohet se kompensimi për funksion shtesë nuk mund të realizohet.

Meqenëse ankuesit kanë parashtruar kërkesë më datë 25.04.2023 ashtu siç parashihet me dispozitat ligjore në fuqi po ashtu edhe referuar Qarkores rreth zbatimit të Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë të lëshuar më datë 22.03.2023 nga Ministria e Punëve të Brendshme, atëherë Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh dispozitat ligjore në fuqi provave të lëndës, si dhe duke ju referuar Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative respektivisht nenit 11 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2, i cili përcakton se: "3. Organi u siguron personave të interesuar dhe palëve informacion të saktë, të qartë dhe të kuptueshëm rreth: 3.2. kërkesave thelbësore ligjore si dhe procedurave e formaliteteve të parashikuara për nxjerrjen e një akti administrativ apo realizimin e një akti real të kërkuar, përfshirë këtu edhe dokumentet dhe deklaratat që

duhen parashtruar", nenit 27 paragrafi 1, i cili përcakton se: "1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, zyrtari përgjegjës zhvillon procedurën administrative, vendos për çështjen, e nënshkruan vendimin si dhe siguron njoftimin e palës", nenit 97 paragrafi 1, i cili përcakton se: "1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative", konstaton se rrjedhë edhe obligimi i Zyrtarit Kryesor Administrativ të Institucionit që në këtë rast është Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Menaxhimin Emerxhent, që në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, është i obliguar që duke marr për bazë të gjitha procedurat ligjore si më lartë dhe ato të sqaruara me Qarkoren rreth zbatimit të Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë të lëshuar më datë 22.03.2023 nga Ministria e Punëve të Brendshme si dhe duke marr parasysh të gjitha komunikimet që janë dërguar nga institucioni përmes përgjigjes në ankesë të datës 08.08.2023, të shqyrtoj kërkesën me Nr. Port: 42 të datës 25.04.2023 të parashtruar nga ankuesit me të gjitha pretendimet, duke nxjerr akt administrativ në pajtim me nenin 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative dhe të njëjtin ta arsyetoj sipas dispozitave të nenin 48 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të këtij ligji.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.1017/2023, datë 08/09/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Menaxhimin Emerxhent;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencisë për Menaxhimin Emerxhent dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.